

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Gazmend Bahtiri dhe sekretaren juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. B. nga fshati D., KK. P., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.8544/13, të datës 23.02.2015, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor publik më dt. 27.12.2016, në prezencën e prokurorit të shtetit Rexhep Maqedonci, të akuzuarit dhe të dëmtuarit A.B., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit:

H. B., nga i ati B. dhe nëna F., e vajzërisë G., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin D., KK. P., ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 nënpar. 1.1 të KPPRK-së,

R E F U Z O H E T A K T A K U Z A

S e p s e:

Më datë 04.12.2013, rreth orës 12:00, në fshatin D., Komuna P., i pandehuri H. B., seriozisht kanos të dëmtuarin A. B., se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit, në atë mënyrë që, me fjalë i drejtohet se 'kur të vij në vëllezërit do t'i thyejmë duart dhe këmbët, kam me ta bërë trupin e zi dhe kam me të larguar nga kjo shtëpi', me ç'rast tek i dëmtuari shkaktohet ndjenja e frikësimit, ankthit dhe pasigurisë për jetën,-

- me këtë kishte për të kryer veprën penale Kanosja nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza gjatë shqyrtimit gjyqësor.

I dëmtuari A. (B.) B. nga fshati D., Komuna e P. nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën, PP/II.nr.8544/13, të datës 23.02.2015, kundër të akuzuarit H. B. nga fshati D., KK. P., për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti shqyrtimin gjyqësor publik me datë 27.12.2016, në të cilin prezantuan Prokurori i Shtetit Rexhep Maqedonci, i akuzuari H. B. dhe i dëmtuari A. B.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se meqenëse procedura penale për veprën penale Kanosje nga neni 185 par.1 të KPRK-së fillohet sipas propozimit të palës së dëmtuar dhe i dëmtuari-dëshmitari A.B. nga fshati D., K P. e tërheqë propozimin për ndjekje të mëtejme penale, konform nenit 52 të KPRK-së, tërhiqem nga ndjekja penale kundër të pandehurit H. B.

Meqenëse Prokurori i Shtetit hoqi dorë nga ndjekja penale, Gjkata mori aktgjykim refuzues me të cilin refuzohet aktakuza për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 454 par.1 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 363 par.1 nënpar. 1.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.202/2015, me datë 27.12.2016

Sekretare juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të njëjtë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.